



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 216

**Tiranë – E martë, 15 dhjetor 2015**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 71, datë 27.11.2015	14341
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 72, datë 27.11.2015	14352
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Adem Peposhi.....	14357



## VENDIM

Nr. 71, datë 27.11.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Vladimir Kristo anëtar i “ “

Sokol Berberi anëtar i “ “

Vitore Tusha anëtare e “ “

Fatmir Hoxha anëtar i “ “

Gani Dizdari anëtar i “ “

Besnik Imeraj anëtar i “ “

Fatos Lulo anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 23.4.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare çështjen nr. 19 Akti që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Lartë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Mimoza Arbri;

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga z. Sokol Pasho;

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare, përfaqësuar në gjykim nga znj. Aurela Anastasi.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i paragrafit të parë të nenit 113 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d”, dhe 145/2, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenet 68 e 70, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkesit dhe të palëve të interesuara, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

## I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 744, datë 6.5.2011, ka vendosur deklarimin fajtorë të të pandehurës B.Q. për kryerjen e veprës penale të prostitucionit, parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal (KP) dhe në lidhje me nenin 51 të KP-së, dënimin e saj me 4 muaj burg. Në aplikim të nenit 406/1 të KPP-së, masës së mësipërme gjykata i ka ulur 1/3 e dënimit të pandehurës, duke e dënuar me 2 muaj e 20 ditë burg. Në bazë të nenit 59 të KP-së është urdhëruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për një kohë prove 18 muaj, me kusht që e pandehura mos të kryejë veprë tjetër penale gjatë kohës së provës.

2. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1430, datë 21.12.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi nga e gjykuara është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 14.5.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (gjykata referuese) ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin para Gjykatës Kushtetuese për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të KP-së, sipas të cilit: “*Ushtrimi i prostitucionit dënobet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet*”.

3. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin e çështjes në seancë plenare. Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve pranoi kërkesën për pjesëmarrjen në gjykimin kushtetues të Qendrës për Nisma Ligjore dhe Qytetare si subjekt i interesuar.

## II

4. **Kërkuesja, gjykata referuese**, vlerëson se paragrafi i parë i nenit 113 të KP-së është në kundërshtim me nenin 18 dhe 17 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW). Në mënyrë të përmbledhur gjykata referuese ka pretenduar shkelje të:

4.1 Parimit të mosdiskriminimit, pasi edhe pse dispozita nuk e ndan dënimin për ushtrim prostitucioni në subjekte të seksit mashkull apo femër, në praktikë dhe nga statistikat, rezulton se shumica e subjekteve që ushtrojnë prostitucion



janë femra. Prandaj, kjo dispozitë rëndon dhe diskriminon femrat në raport me meshkujt. Dispozita nuk duhet të synojë dënimin e ushtrimit të prostitucionit, por trafikimin dhe shfrytëzimin për prostitucion të vajzave dhe grave, pasi këto të fundit në shumicën e rasteve janë viktima dhe jo fajtores.

4.2 Parimit të proporcionalitetit, pasi ndëshkimi penal për këtë veprë nuk është në raport me interesin publik dhe moralin publik që kërkohet të mbrohet. Jo vetëm dënimi deri në 3 vjet është i pajustificuar, por edhe ndëshkimi në vetvete nuk qëndron, sepse vajzat dhe gratë janë shpesh viktima të prostitucionit dhe trafikimit për qëllime seksuale. Vepra penale e ushtrimit të prostitucionit nuk mund të synojë riedukimin dhe më pas integrimin e ushtrueses së prostitucionit, prandaj dhe nuk i përgjigjet kërkesës kushtetuese të përpjesëtushmërisë mes dënimit penal dhe veprës së kryer në këndvështrim të nenit 17/1 të Kushtetutës.

5. Gjithashtu, sipas gjykatës referuese, edhe pse sugjerimet e Komitetit për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave nuk kanë forcë detyruese, ky Komitet, në Vërejtjet Përmbyllëse të Raportit të Tretë Periodik për Shqipërinë (2003), e ka këshilluar vendin tonë të ndryshojë Kodin Penal, në mënyrë që ushtrimi i prostitucionit të mos jetë i parashikuar si veprë penale dhe të mos dënohet, por të merren masa për programe mbështetjeje për vajzat dhe gratë, të cilat kërkojnë të largohen nga ushtrimi i prostitucionit.

6. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se:

6.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet për kontrollin incidental, pasi ajo nuk ka hetuar nëse për zgjidhjen e çështjes konkrete kishte dispozita të tjera zbatuese. Në rastin konkret, e akuzuara dhe e dënuara ishte e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, prandaj Gjykata e Lartë nisur nga ky fakt, nga rrezikshmëria e vogël e veprës penale, si dhe nga rrethanat e kryerjes së veprës, bazuar në nenin 441/b të KPP-së, mund ta zgjidhte çështjen duke vendosur përjashtimin e së miturës nga dënimi.

6.2 Neni 113 i KP-së nuk bën dallim mes subjekteve të veprës penale të prostitucionit në bazë të gjinisë. Po ashtu, kjo dispozitë nuk bën dallim mes ushtruesit/es të prostitucionit dhe përfituesit/es nga prostitucioni.

6.3 Me shtesat dhe ndryshimet e bëra në Kodin Penal, nëpërmjet ligjit nr. 23/2012, janë konsideruar të dënueshme veprimet e kryera si nga ushtruesi i prostitucionit, ashtu edhe nga përfituesi i marrëdhënies seksuale në mënyrë të paligjshme. Kjo shtesë eliminon pabarazinë apo diskriminimin që konstatohej nga organet ligjzbatuese gjatë hetimit dhe gjykimit të kësaj veprë penale.

6.4 Parashikimi i ushtrimit të prostitucionit si veprë penale është në përputhje me moralin e shoqërisë shqiptare, e cila në kushtet aktuale e ka të vështirë të pranojë prostitucionin si veprimtari ekonomike për ato vajza dhe gra që dëshirojnë ta ushtrojnë atë me vullnet të lirë.

6.5 Neni 113 i KP-së respekton kriteret e proporcionalitetit, pasi ligjvënësi ka respektuar kufizimin e lirisë për veprën e prostitucionit në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar.

7. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka paraqitur këto argumente:

7.1 Neni 113 i Kodit Penal nuk vjen në kundërshtim me nenin 6 të CEDAW-s, pasi kjo konventë nuk përmban një rregullim normues, por është dispozitë që shpreh angazhimin e shteteve për të siguruar luftën ndaj formave të shfrytëzimit të vajzave dhe grave, që nuk gjen zbatim të drejtpërdrejtë.

7.2 Neni 113 i Kodit Penal ndëshkon ushtrimin e prostitucionit si veprë penale që nuk lidhet në asnjë formë apo mënyrë me shfrytëzimin e prostitucionit, pasi këto vepra kanë masa më të ashpra dënimi.

7.3 Legjislatori është ai që përcakton veprimet apo mosveprimet e dëmshme për shoqërinë dhe si të tilla i sanksionon edhe si vepra penale. Synimi i ligjvënësit me parashikimin si veprë penale të ushtrimit të prostitucionit është mbrojtja e moralit të shoqërisë.

8. **Subjekti i interesuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)**, ka argumentuar se:

8.1 Neni 113 i KP-së, në dukje një dispozitë e paanshme, vendos grupin e vajzave dhe të grave në kushte jo të favorshme, për shkak të gjinisë së tyre, në raport me personat që përfitojnë marrëdhënie seksuale në mënyrë të paligjshme, të cilët nuk ndëshkohen. Edhe ndryshimi që i është bërë nenit 113 të Kodit Penal nuk e zgjidh çështjen e mosdiskriminimit të grave dhe të vajzave.



8.2 Ushtrimi i prostitucionit është i lidhur ngushtësisht me shfrytëzimin e trafikimitin e vajzave dhe të grave. Shfrytëzuesit dhe trafikantët shpeshherë rastet e shfrytëzimit i manipulojnë dhe i paraqesin si ushtrim prostitucioni.

8.3 Në luftën kundër diskriminimit dhe në respekt të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, morali, zakonet ose traditat nuk mund të shërbejnë si justifikim i ligjshëm dhe objektiv në asnjë rast.

**9. Subjekti i interesuar, Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare (QNLQ)** ka argumentuar se:

9.1 Neni 113 i KP-së, nga mënyra se si është formuluar, nuk e shikon dhe ndëshkon prostitucionin si një nga format e dhunës me bazë gjinore, si dhe nuk e lidh atë qartësisht me prostitucionin vullnetar, për rrjedhojë dënon vetëm viktimat e këtij fenomeni.

9.2 Sipas monitorimeve të QNLQ-së, personi që e ushtron prostitucionin kundrejt pagesës është femër dhe personi që e blen atë si rregull është mashkull. Pra, pavarësisht se ligji nuk bën ndarje të roleve, realiteti ofron një ndarje të tillë mbi baza gjinore.

9.3 Motivi që i shtyn vajzat dhe gratë drejt prostitucionit nuk është përfitimi, por mbijetesja dhe në këtë kuptim ato duhen trajtuar si grupe vulnerable në aspektin social dhe ekonomik.

9.4 Neni 113 i KP-së cenon edhe procesin e rregullt ligjor, pasi është e qartë se të provuarit e dhënies ose jo të pëlqimit është çështje e vështirë dhe kjo e bën procesin joefektiv, në të cilin mund të kriminalizohen edhe vetë viktimat e shfrytëzimit dhe të trafikimit.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin dhe juridiksionin e Gjykatës

10. Gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nëse plotëson kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese". Neni 145/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj

dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuar nga Gjykata Kushtetuese, por që për nismëtarë ka gjykatat e sistemit të zakonshëm.

11. Gjykata në vazhdimësi ka vlerësuar se që të legjitimohet gjykata referuese, gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar / identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të ketë parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 7, datë 27.2.2013; nr. 39, datë 30.6.2014; nr. 7, datë 16.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa u përket kritereve "i" dhe "ii" të sipërcituara, që janë të ndërlidhura me juridiksionin e Gjykatës (*rationae materie*), Gjykata çmon të japë disa vlerësime mbi kontrollin kushtetues të normës penale, që përcakton masën e dënimit, si kompetencë kushtetuese e ligjvënësit.

13. Kështu, Gjykata thekson se në shkronjën "a", të nenit 131, të Kushtetutës, është përcaktuar kompetenca e saj për të shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare. Kushtetuta vendos detyrime dhe kufizime për ligjvënësin, të cilat në shkallë të fundit kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese, funksioni i së cilës është garantimi i respektimit dhe interpretimi përfundimtar i Kushtetutës (*neni 124 i Kushtetutës*).

14. Kuvendi, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, vendos dhe konkretizon politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, ose u përgjigjet prioritetëve apo problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, ligjet ose dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat



e Kushtetutës. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara nuk shkelin normat dhe vlerat kushtetuese.

15. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë të ligjeve, kjo Gjykatë nisat nga prezumimi i kushtetutshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse para Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 16, datë 25.7.2008; 12, datë 14.4.2010; nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen në shqyrtim janë ngritur dy pretendime për mosrespektim të normave kushtetuese, të lidhura me parimin e mosdiskriminimit dhe të proporcionalitetit. Në lidhje me mosdiskriminimin, Gjykata ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 39, datë 16.10.2007; nr. 4, datë 12.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndërsa, më specifikisht, gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të disa normave penale, objekt gjykimi, kjo Gjykatë ka theksuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Por, që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën (*shih vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata çmon se në rastin konkret para saj është pretenduar dhe janë paraqitur arsye për shfuqizimin e veprës penale të ushtrimit të prostitucionit, për shkak se bie në kundërshtim me nenet 18 dhe 17 të Kushtetutës, prandaj dhe kjo Gjykatë ka juridiksion (*rationae materie*) për shqyrtimin e këtyre pretendimeve.

18. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kjo çështje plotëson edhe kriteret “iii” dhe “iv” të legjitimitetit për kontrollin konkret të normës

juridike, sepse për dënimin e ushtrueses së prostitucionit për veprën penale të prostitucionit, parashikuar nga neni 113/1 i KP-së, gjykata referuese nuk mund të përfundonte gjykimin në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese, si dhe nuk kishte dispozita të tjera për t’iu referuar për zgjidhjen përfundimtare të çështjes (§11).

*B. Për pretendimin për diskriminim në kundërshtim me kërkesat e nenit 18 të Kushtetutës*

19. Gjykata referuese pretendon se neni 113 i KP-së, paragrafi i parë, krijon diskriminim mbi baza gjinie, pasi për veprën penale “ushtrim prostitucioni” dënohen më shumë femrat se sa meshkujt. Në këto kushte, edhe pse në pamje të parë dispozita nuk duket diskriminuese, në fakt ajo diskriminon vajzat dhe gratë që ushtrojnë prostitucion. Të njëjtin argument parashtron dhe KMD-ja në parashtrimet me shkrim, ashtu sikundër dhe QNLQ-ja.

20. Kushtetuta, në nenin 18, parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

21. Në kontekstin e Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, shprehja “diskriminimi ndaj grave” nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e seksit e që ka për pasojë ose për qëllim të komprometojë ose të asgjësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga gjendja e tyre martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër (*neni 1*). Kjo konventë u kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e përshtatshme në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, duke përfshirë edhe legjislationin, për të siguruar zhvillimin dhe përparimin e grave, me qëllim që t’u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut mbi bazën e barazisë me burrat (*neni 3*).



Nga ana tjetër, kjo konventë i jep njohje formale ndikimit të kulturës, traditës, modeleve sociale, stereotipave të burrit dhe të gruas, si pengesa reale që diktojnë kufizimin në gëzimin e plotë dhe efektiv të të drejtave themelore nga gratë (neni 5).

22. Kjo Gjykatë thekson se CEDAW-ja ka një rëndësi të posaçme, pasi sjell në vëmendje dhe në një fokus të veçantë të drejtat e vajzave dhe të grave, mbrojtjen dhe respektimin e dinjitetit të tyre, barazinë mes tyre dhe burrave, si dhe mënyrën se si mund të realizohen këto të drejta. Duke pasur parasysh këto konsiderata, Gjykata vlerëson pretendimet për papajtueshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të Kodit Penal me kërkesat e parimit të mosdiskriminimit.

23. Në lidhje me veprën penale të ushtrimit të prostitucionit, neni 113 i KP-së i miratuar në vitin 1995, parashikonte vetëm një paragraf, sipas të cilit: *“Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet”*. Me ligjin nr. 23/2012, është shtuar edhe një paragraf i dytë, ku përcaktohet se *“dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose burg deri në 3 vjet”*.

24. Vepra penale e ushtrimit të prostitucionit përfshihet në seksionin VIII të Kodit Penal, i cili synon mbrojtjen e moralit dhe të dinjitetit të personit. Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit janë ato veprime ose mosveprime të kundërligjshme, shoqërisht të rrezikshme, të kryera me faj. Ligjvënësi, me parashikimin e kësaj vepre penale, është nisur nga një qëllim i ligjshëm: mbrojtja e normave të moralit të shoqërisë sonë. Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për ndalimin e ushtrimit të prostitucionit, që pasqyrojnë e harmonizohen me normat morale të shoqërisë sonë, të cilat janë në kundërshtim me këtë dukuri shoqërore, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Nga ana objektive kjo vepër penale kryhet nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, si burim jetese, për qëllime fitimprurëse ekonomike. Subjekt i veprës penale është çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa nga ana subjektive kjo vepër kryhet me dashje.

25. Gjykata konstaton se edhe duke iu referuar Vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2010, për veprën penale të prostitucionit, bazuar në nenin 113 të KP-së, janë dënuar 39 persona, nga këta 36

janë femra (f. 39, 85); për vitin 2011 janë dënuar 29 persona, nga këta 23 janë femra (f. 55, 85); për vitin 2012 të dënuar për veprën penale të prostitucionit janë 22 persona, nga këta 18 janë femra (f. 57, 82); për vitin 2013 (pas hyrjes në fuqi të § të dytë të nenit 113 të KP-së) rezulton se janë dënuar 20 persona, nga këta 18 janë femra.

26. Në këndvështrim të këtyre statistikave, Gjykata vëren se ashtu sikundër parashtron edhe pala e interesuar, QNLQ-ja, shumica e të dënuarve për veprën penale të prostitucionit janë femra. Sipas Gjykatës, arsyet dhe shkaqet pse një vepër penale është më e përhapur në një kategori të caktuar popullsie (në rastin konkret të gjinia femër) mund të jenë të ndryshme dhe të ndikuara nga shumë faktorë. Në vijimësi të kësaj logjike, gjykata argumenton se fakti që vepra penale, si p.sh. vrasja dhe vjedhja, janë më të përhapura në subjekte meshkuj, nuk mund të interpretohet si diskriminim mbi baza gjinie për këtë kategori autorësh të këtyre veprave penale. Për rrjedhojë, pretendimi në lidhje me statistikën i paraqitur në gjykim nga QNLQ-ja nuk përbën argument bindës dhe nuk mund të interpretohet si diskriminim, që vjen si rrjedhojë e parashikimeve të nenit 113 të KP-së.

27. Në vlerësimin e Gjykatës janë organet zbatuese dhe kontrolluese të respektimit të dispozitave penale me objekt luftën ndaj prostitucionit të detyruar ose me vullnet të lirë, konkretisht prokuroria dhe gjykatat, të cilat kanë për detyrë zbatimin e legjislacionit përkatës, duke shmangur diskriminimin që mund të shkaktohet mbi baza gjinie gjatë hetimit dhe shqyrtimit të këtyre çështjeve. Ashtu sikundër kjo Gjykatë ka theksuar gjatë jurisprudencës së saj, mënyra e të zbatuarit të ligjit nuk është çështje që i përket kontrollit kushtetues, për rrjedhojë nuk është objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 35, datë 10.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Bazuar në analizën e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se neni 113 i KP-së nuk përmban diferencim në përcaktimin ligjor, pasi dënon autorët e prostitucionit, që mund të jenë femra ose meshkuj. Për më tepër, dispozita dënon subjektet, kategorinë e meshkujve/-femrave që ushtrojnë prostitucion me vullnet të lirë. Ndërkohë, pala e interesuar, QNLQ-ja, kërkon të mbrojë kategorinë e vajzave dhe të grave që ushtrojnë prostitucion nën kushtet e dhunës dhe të kanosjes. Në fakt, kjo



kategori, pra, viktimat, mbrohet sipas nenit 114 të KP-së, i cili parashikon se shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Po e njëjta dispozitë, shkronja “a”, parashikon “shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese” dhe dënimin nga 7 deri 15 vjet, si dhe konfiskimin e mjeteve dhe të përfitimeve, kurse shkronja “b” parashikon “trafikimin e femrave” dhe dënimin e autorëve për këtë veprë penale. Për rrjedhojë, është kjo dispozitë me përcaktimet përkatëse që mbron vajzat dhe gratë e shfrytëzuara e të dhunuara, si dhe dënon shfrytëzuesit dhe trafikuesit e prostitucionit.

29. Bazuar në sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi që vepra penale e prostitucionit, parashikuar në nenin 113 të KP-së, bie në kundërshtim me nenin 18 të Kushtetutës, pasi diskriminon vajzat dhe gratë që ushtrojnë prostitucion, është i pabazuar.

*C. Për pretendimin për cenim të parimit të proporcionalitetit në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës*

30. Gjykata referuese argumenton se neni 113 i KP-së nuk respekton parimin e proporcionalitetit, pasi ndëshkimi penal për këtë veprë nuk është në raport me interesin publik dhe moralin publik që kërkohet të mbrohet. Jo vetëm dënimi deri në 3 vjet është i pajustificuar, por edhe ndëshkimi në vetvete nuk qëndron, sepse vajzat dhe gratë janë shpesh viktime të prostitucionit dhe trafikimit për qëllime seksuale. Subjekti i interesuar, QNLQ-ja, ka pretenduar se dënimi me burg, si aspekt i kufizimit të lirisë në rastin e konsumimit të veprës penale të ushtrimit të prostitucionit, është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, pasi kjo veprë mund të dënohej administrativisht dhe jo penalisht. Po sipas këtij subjekti, dënimi është disproporcional edhe në masën e dënimit, nga gjobë deri 3 vjet burg.

31. Në mënyrë që t'i përgjigjet këtij pretendimi, në pikëpamje të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, Gjykata vlerëson kriteret sipas nenit 17 të Kushtetutës, konkretisht, që: i) kufizimi të realizohet me ligj; ii) të jetë bërë për interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; iii) të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar; të mos cenojë thelbin e të drejtave dhe të lirive themelore.

32. Në lidhje me proporcionalitetin, Gjykata ka theksuar se në thelb të këtij parimi qëndron “ekuilibrimi i drejtë i interesave”, vlerësimi i rëndësishëm dhe objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre. Një kufizim do të konsiderohej në përputhje me standardet e parimit të proporcionalitetit nëse: i) objektivi i ligjvënësit është mjaftueshëm i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii) masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin - ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii) mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa për të arritur objektivin e kërkuar - sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër objektivi për t'u arritur duhet të jetë i rëndësishëm, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme” (shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012, i Gjykatës Kushtetuese).

33. Nga një vështrim i përgjithshëm krahasimor në disa nga vendet evropiane, por edhe më gjerë, Gjykata konstaton se ushtrimi i prostitucionit mund të jetë i ligjshëm nën regjimin juridik të veprimtarisë ekonomike (p.sh., Holanda, Gjermania), mund të jetë i paligjshëm ose mund të trajtohet nën një regjim tjetër juridik.<sup>1</sup> Konkretisht, në Suedi, sipas të ashtuquajturit “model nordik” ose “model rregullator”, penalizohet blerja e aktit seksual dhe është dekriminalizuar shitja e aktit seksual. Nga ana tjetër, ushtrimi i prostitucionit në disa legjislacione reflektohet si kundërvajtje administrative, si në Kroaci<sup>2</sup> apo Lituanisë<sup>3</sup>, ashtu sikundër dhe vende të rajonit, si Maqedonia<sup>4</sup> dhe Mali i Zi<sup>5</sup> e konsiderojnë ushtrimin e prostitucionit veprë penale.

34. Nga sa më lart, ashtu si dhe QNLQ-ja ka

<sup>1</sup> Prostitution.procon.org 2010, 100 Countries and Their Prostitution Policies, 2010, ProCon.org, Online <http://prostitution.procon.org/view.resource.php?resourceID=000772>

<sup>2</sup> Në ligjin “Mbi kundërvajtjet kundër rendit publik dhe paqes” të Kroacisë, përcaktohet kriminalizimi i kujdo që angazhohet në prostitucion, duke e dënuar me gjobë apo burgim deri në 30 ditë (neni 12).

<sup>3</sup> Në Kodin e Kundërvajtjeve Administrative të Lituanisë, personi që ofron shërbime seksuale dhe ai që përfiton këto shërbime me pagesë dënohet me gjobë nga 300 deri 500 litas (monedha e vendit).

<sup>4</sup> Neni 191 i Kodit Penal të Maqedonisë.

<sup>5</sup> Neni 208 i Kodit Penal të Malit të Zi.



argumentuar, rezulton se ka zgjidhje të ndryshme ligjore në lidhje me fenomenin e prostitucionit dhe se disa shtete rajonale e kanë konsideruar si kundërvajtje administrative me masa më të buta dënimi. Në këtë kuptim, *prima facie* duket se ekzistojnë masa të tjera edhe më të buta legjislative në lidhje me përcaktimin e prostitucionit si një veprimtari e dënueshme. Megjithatë, parimi i proporcionalitetit kërkon që në thelb masa të jetë mjaftueshëm e rëndësishme për të justifikuar kufizimin e së drejtës dhe të jetë e nevojshme aq sa për të arritur objektivin e ligjshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata rithekson se në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë, si dhe duke përcaktuar mjetet të cilat përdor për t'i arritur këto qëllime. Ashtu sikundër ka theksuar edhe më lart (*supra*, §15), kjo gjykatë prezumon pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, derisa palët t'i provojnë asaj të kundërtën.

35. Në rastin konkret, para gjykatës, gjatë gjykimit në seancë gjyqësore, nuk u paraqitën argumente bazuar mbi të dhëna/statistika, në kuptim të testit kushtetues të proporcionalitetit, mbi ashpërsinë e masës konkrete nga palët që mbrojnë viktimat e prostitucionit, duke vërtetuar se pikërisht dekriminalizimi i kësaj vepre penale mund të ulte shfrytëzimin dhe trafikimin e vajzave dhe grave për prostitucion. Edhe pse Gjykata pranon se ushtrimi i prostitucionit mund të jetë i lidhur me shfrytëzimin e vajzave dhe të grave për prostitucion, palët nuk arritën t'i provojnë gjykatës se zbutja e masës së marrë nga ana e ligjvënësit do të sillte për pasojë mbrojtje më të madhe për viktimat e prostitucionit ose do të parandalonte shfrytëzimin dhe trafikimin, si dhe dhunën ndaj vajzave dhe grave.

36. Në vijimësi, Gjykata vlerëson se asnjë nga palët në gjykim nuk paraqiti të dhëna për të argumentuar se viktimat e prostitucionit mbrohen më mirë me dekriminalizimin e kësaj vepre penale ose me përcaktimin e kësaj vepre si kundërvajtje administrative. Për këtë arsye kjo gjykatë nuk ka mjaftueshëm të dhëna për shfuqizimin e kësaj vepre penale. Prandaj, për sa kohë që parashikimi i prostitucionit si veper penale, por edhe dënimi nga gjobë deri në 3 vjet, nuk duken haptazi disproporcionalë, kjo gjykatë nuk mund të arrijë në

konkluzionin se parashikimi i prostitucionit si veper penale e dënueshme është më e ashpër se sa objektivi që ka për qëllim ligjvënësi për të arritur apo se kjo masë është e paarsyeshme nga ana e ligjvënësit.

37. Për më tepër, Gjykata vlerëson se gjykatat e kanë hapësirën e vlerësimit që për veprën penale të ushtrimit të prostitucionit, në marzhin e dënimit nga gjobë deri në 3 vjet, në zbatim të nenit 47 të Kodit Penal, në caktimin e dënimit të marrin parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Pra, ligjvënësi, me përcaktimin e dënimit për këtë veper penale nga gjoba deri në 3 vjet, e ka përlloritur marzhin e proporcionalitetit si në dispozitën ligjore, ashtu edhe në hapësirën e lejuar gjykatave për zbatimin në praktikë të dispozitës sipas specifikës së rastit në gjykim. Gjithashtu, gjykatat kanë në dispozicion të tyre edhe mundësinë e dhënies së dënimeve alternative, deri edhe përjashtim nga dënimi, si masa më të buta, përsëri në varësi të rastit, në përputhje me legjislacionin penal.

38. Për sa më lart, Gjykata konkludon se pretendimet e kërkuesit për shfuqizim të nenit 113, paragrafi i parë, të Kodit Penal, për mosrespektim të parimit të barazisë dhe të proporcionalitetit, sipas neneve 18 dhe 17 të Kushtetutës, duhen rrëzuar si të pabazuara.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134, pika 1, shkronja “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtare kundër: Vitore Tusha





## MENDIM PARALEL

1. Gjykata e Lartë (gjykata referuese) i është drejtuar kësaj Gjykate për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të KP-së, sipas të cilit: “*Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet*”. Gjykata referuese ka pretenduar se dispozita e lartpërmendur bie ndesh me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), duke cenuar në këtë mënyrë parimin e proporcionalitetit dhe atë të mosdiskriminimit.

2. Pavarësisht se lidhur me zgjidhjen e çështjes në themel pajtohem me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me arsyetimin e saj për sa i takon juridiksionit të kësaj Gjykate për shqyrtimin e çështjes në fjalë.

3. Shumica edhe pse shprehet se Kuvendi, në ushtrimin e funksionit ligjvënës, vendos dhe konkretizon politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, ose u përgjigjet prioriteteve apo problemeve të ndryshme të vendit (shih paragrafin nr. 14 të vendimit), ka arritur në përfundimin se në rastin konkret, duke qenë se sipas gjykatës referuese vepra penale e ushtrimit të prostitucionit bie në kundërshtim me nenet 17 dhe 18 të Kushtetutës, kjo Gjykatë ka juridiksion (*rationae materie*) për shqyrtimin e çështjes.

4. Argumentet e shumicës për të justifikuar juridiksionin e Gjykatës na duken të sforcuara. Jemi të mendimit se çështja objekt shqyrtimi nuk hyn në juridiksionin kushtetues, për arsytet si më poshtë vijojnë.

5. Ndryshe nga shumica vlerësojmë se me gjithë përpjekjet e gjykatës referuese për të parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të KP-së, në përmbushje të kriterëve të përcaktuara nga kjo Gjykatë për kontrollin incidental, mendojmë se në thelb kërkesa dhe natyra e pretendimeve lidhen me dekriminalizimin e veprës penale të prostitucionit.

6. Në këtë këndvështrim, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar në mënyrë të përsëritur se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas

rasti, është në diskrecion të gjykatës (*shih vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, sikurse thekson edhe shumica, Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit është Kuvendi që, si organ ligjvënës, ka të drejtën të zbatojë apo të konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, apo t'u përgjigjet prioriteteve ose problemeve të ndryshme të vendit (*shih vendimet nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 43, datë 6.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Është e rëndësishme për çdo shtet të së drejtës, që zbaton rregullat e një shoqërie demokratike, që ligjvënësi të gëzojë hapësira të konsiderueshme për të përcaktuar rregulla dhe kriteret e drejta brenda rendit të tij kushtetues, në përputhje me kushtet konkrete, si dhe me faktorët e ndryshëm politikë, historikë, socialë, kulturorë e tradicionalë, të cilët janë përcaktues (*shih vendimin nr. 20, datë 15.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Këto parime trajtohen edhe në doktrinën kushtetuese, sipas të cilës është atribut i ligjvënësit të përcaktojë se cilat veprime duhet të ndëshkohen, me çfarë dënimi dhe në çfarë mënyre dhe se ky diskrecion i ligjvënësit mund të jetë objekt “censure” në gjykimin kushtetues vetëm kur ushtrohet në mënyrë arbitrare. Për rrjedhojë, jemi të mendimit se përcaktimi i veprave penale apo dekriminalizimi i tyre hyn në sferën e zgjedhjeve diskrecionale të ligjvënësit, i cili mund të formulohet në mënyra të ndryshme në kohë të caktuara, nivelin e ndërhyrjes ndaluese në fusha të ndryshme. Çka passjell që Gjykata mund të gjykojë themelin e zgjedhjeve të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, vetëm nëse ato vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës.

8. Po në këtë kontekst, edhe Gjykata Kushtetuese Italiane është shprehur se “*vlerësimet nga të cilat varet vendimi për të dekriminalizuar apo jo një veprë penale varen nga konsiderata të përgjithshme (funksioni i shtetit, sistemi penal, dënimi penal) dhe të veçanta (dëmi social i shkaktuar nga vetë ekzistenca e inkriminimit), që për natyrën e tyre janë autentike ideologjike dhe politike dhe si të tilla mund të kontrollohen vetëm nën dritën e kriterit të arsyeshmërisë*” (shih vendimet nr. 447/1998; nr. 262/2005; nr. 250/2010, të Gjykatës Kushtetuese Italiane).

9. Vepra penale e prostitucionit, sikurse vërehet në seksionin VIII të kreut II të Pjesës së



Posaçme të Kodit Penal, hyn në veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit. Pra, qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet inkriminimit të fenomenit të prostitucionit është mbrojtja e moralit dhe dinjitetit të njeriut. Garantimi i këtyre të drejtave, sikurse u theksua më lart, lidhet ngushtë me faktorë të ndryshëm, politikë, sociale, ekonomike, historike apo tradicionale të vendit, vlerësimi i të cilëve, si dhe gjetja e ekuilibrit të interesave është tagër i ligjvënësit. Evolucioni i këtyre faktorëve ka bërë që aktualisht shoqëria dhe vende të ndryshme të kenë qasje të ndryshme ndaj fenomenit të prostitucionit, fillimisht i gjykuar si fenomen shoqërisht i papranueshëm dhe jo i moralshëm. Kështu, në praktikën e rrethit të ndryshme juridike, në ditët e sotme fenomeni i prostitucionit gjën rregullime të ndryshme, të cilat i përgjigjen vlerësimit nga ana e ligjvënësit të faktorëve të lartpërmendur<sup>6</sup>.

10. Nga sa më lart, mendojmë se parashikimi si vepra penale i veprimeve/mosveprimeve që në një moment të caktuar cenojnë rëndë marrëdhëniet shoqërore apo dekriminalizimi i tyre në një moment tjetër, janë kompetenca ekskluzive të Kuvendit dhe si të tilla nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga kjo Gjykatë. Duke ju kthyer çështjes konkrete vërejmë se edhe në praktikën e vendeve të tjera evropiane fenomeni i prostitucionit, edhe pse është një çështje e debatueshme, gjithsesi ngelet gjithmonë në vullnetin dhe vlerësimin e organit ligjvënës.

11. Si përfundim, mendojmë se Gjykata duhet të vendoste rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se shqyrtimi i saj nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vladimir Kristo

#### MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky vendim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

<sup>6</sup> Tri janë modelet evropiane juridike dominuese: modeli ndalues ose inkriminues (pjesa më e madhe e vendeve të Lindjes), ai shfuqizues (Evropa Perëndimore) dhe ai rregullator (Vendet e Ulëta, Gjermania, Turqia, Austria, Zvicra, Greqia, Hungaria dhe Lituania).

2. Gjykimi kushtetues është vënë në lëvizje mbi kërkesën e paraqitur nga Gjykata e Lartë për kontrollin incidental të nenit 113, paragrafi i parë, të Kodit Penal. Kjo e fundit, në vendimin e pezullimit të shqyrtimit të çështjes penale ka pretenduar papajtueshmërinë e nenit 113/1 të KP-së me Kushtetutën, duke renditur si shkaq mosrespektimin nga ligjvënësi në hartimin e dispozitës penale të nenit 6 të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave dhe Vajzave (CEDAW) të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe të parimit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, në referim të neneve 18 dhe 17 të Kushtetutës.

3. Shumica, midis të tjerash, ka arritur në përfundimin se pretendimi për diskriminim duhet rrëzuar si i pabazuar. Edhe pse shumica shprehet se i vlerëson pretendimet për papajtueshmërinë e paragrafit të parë të nenit 113 të Kodit Penal me kërkesat e parimit të mosdiskriminimit, një analizë e tillë, ndërsa duhet të sillte në vëmendje qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese në këtë drejtim, në fakt ajo mungon, pasi vendin e këtij arsytimi e zë qëndrimi që mban doktrina e së drejtës penale në lidhje me elementet e veprës penale të prostitucionit.

4. Për sa i takon konkluzionit statistikor të paraqitur në gjykim nga subjekti i interesuar, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, se shumica e të dënuarve për veprën penale të prostitucionit janë femra, shumica shprehet se nuk mund të interpretohet si problem diskriminimi që vjen si rrjedhojë e parashikimeve të nenit 113 të KP-së. Madje në vlerësimin e shumicës, dispozita objekt kundërshtimi dënon ato subjekte që e ushtrojnë prostitucionin me vullnet të lirë, pavarësisht gjinisë së tyre, prandaj edhe pretendimi për diskriminim mbi baza gjinie në parashikimin e ushtrimit të prostitucionit si vepër penale është i pabazuar. Për më tepër, shumica shprehet se kategoria e grave që ushtrojnë prostitucion nën kushtet e dhunës dhe kanosjes mbrohet sipas nenit 114 të KP-së.

5. Çështja objekt shqyrtimi lidhet me një fenomen tepër të vështirë për t'u matur dhe vlerësuar, për faktin se prostitucioni ushtrohet në mënyrë të paligjshme në shumicën e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE), por dhe jashtë saj. Statistikisht, sipas një raporti të vitit 2012, prostitucioni ka një dimension global që përfshin rreth 40–42 milionë njerëz, 90% e të cilëve janë të



varur nga një tutor.

6. Po ashtu, pranohet gjerësisht se prostitucioni mbetet një çështje sociale dhe ekonomike, që kërkon zbatimin e politikave publike dhe masave të tjera ndërhyrëse me natyrë sociale me qëllim zgjidhjen e nevojave të punëtorëve të seksit dhe komuniteteve të tyre, megjithatë ka pak të dhëna në lidhje me faktin nëse një lloj i veçantë përqasjeje i përmbush të gjitha këta objektiva.

7. Zgjidhjet legjislative ndaj veprës penale të prostitucionit variojnë duke përfshirë jo vetëm forcimin e masave në dispozitat penale që lidhen me prostitucionin e të rriturve, por edhe shfuqizimin e ligjeve që e rregullojnë atë. Pavarësisht regjimeve të ndryshme juridike ndaj prostitucionit, përqasjet ligjore ndaj këtij fenomeni grupohen në disa kategori: kriminalizimi i prostitucionit (si për punëtorët e seksit, ashtu dhe klientët); kriminalizimi i klientëve, rregullimi (jo domosdoshmërisht legalizim) dhe dekriminalizimi, ku secila prej tyre paraqet veçori të dallueshme.<sup>7</sup>

8. Përveç faktit që ekzistenca e disa përqasjeve konkurruese e bën të vështirë përzgjedhjen e politikës më të përshtatshme për të adresuar këtë fenomen, ajo çfarë e vështirëson edhe më shumë situatën ka të bëjë me faktin se prostitucioni përfshihet në listën e fenomeneve, si: aborti, martesë mes së njëjtës gjini, riprodhimi i asistuar, eutanazia etj., politikë ndaj të cilave përkufizohen si politika morali.

9. Duhet pranuar që ndaj politikave të moralit bëhet qëndresë e madhe, por ndërsa ky pohim mund të jetë i pranueshëm kur gjen zbatim ndaj publikut ose medias, por kur vjen fjala për gjyqtarin kushtetues çështja duhet trajtuar nga këndvështrimi i parimeve dhe vlerave kushtetuese që shtrohen për diskutim, me qëllimin për të gjetur balancën e duhur midis tyre. Kjo përqasje e gjyqtarit kushtetues nuk e kthen atë aspak në ligjvënës pozitiv, por përbën një mundësi për gjyqësorizimin e procesit të hartimit të politikave dhe krijimin e një

dialogu kushtetues midis gjyqësorit kushtetues dhe politikës (ligjvënësit) si mekanizmi më i rëndësishëm për mbrojtjen e supremacisë së Kushtetutës, për dhënien e drejtësisë efektive, duke garantuar e mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore.

10. Prostitucioni, pavarësisht nëse është i detyruar apo vullnetar, si dhe shfrytëzimi seksual i grave dhe vajzave cilësohen si forma të dhunës kundër tyre, cenuese të dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave e lirive themelore. Sot, politikë e BE-së, me qëllim parandalimin e prostitucionit, bazohen mbi prezumimin se virtualisht të gjithë ata që blejnë shërbime seksuale janë meshkuj. Në këtë kuptim, edhe pse virtual, elementi statistikor në lidhje me përkatësinë gjinore të klientit nuk anashkalohet, por merret si pikë referimi për hartimin e një kuadri ligjor garantues të dinjitetit njerëzor dhe të barazisë gjinore.

11. Nëse sipas shumicës elementi statistikor nuk përbën argument kushtetues, çfarë mund të thuhet për dinjitetin e njeriut ose për barazinë gjinore kur analizojmë fenomenin global të prostitucionit?!

12. Sipas nenit 3 të Kushtetutës, dinjiteti i njeriut përbën një nga bazat e shtetit, të cilat ky i fundit duhet t'i respektojë, të mbroje dhe t'i garantojë. Nga ana tjetër, barazia gjinore, sipas nenit 18/1 të Kushtetutës apo instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, përbën një tjetër vlerë që duhet të garantohet nga Kushtetuta.

13. Prostitucioni përbën cenim të dinjitetit njerëzor dhe të të drejtave e lirive themelore. Ky fenomen është i lidhur me barazinë gjinore për shkak të lidhjes së drejtpërdrejtë dhe ndikimit mbi rolin dhe vendin e gruas në shoqëri, përfshirjen e saj në tregun e punës, vendim-marrjen, shëndetin dhe arsimin dhe për zgjedhjet që asaj i janë ofruar nisur nga pabarazia gjinore strukturore. Dëshpërimi financiar si rezultat i krizës aktuale financiare përbën shkak për shfrytëzimin ekonomik të grave e vajzave, kryesisht të nënave të vetme, që po përfshihen në prostitucion në vendet e tyre ose jashtë.<sup>8</sup>

14. Përveç sa më sipër, një fakt tjetër që nuk duhet anashkaluar është lidhja e drejtpërdrejtë që ekziston midis prostitucionit dhe trafikimit të kimit të organizuar.<sup>9</sup> Prostitucioni në BE dhe në

<sup>7</sup> Modelet kryesisht ndahen në dy kategori: *abolitionist approach*, që kriminalizon biznesin e prostitucionit ose pjesë të tij, model që u zbatua në vitin 1999 në Suedi dhe u ndoq nga Norvegjia, Irlanda, Islanda, Franca, UK etj., dhe *regulatory approach*, që nuk i jep fund prostitucionit, por pranon shitjen dhe blerjen e seksit si një aktivitet ekonomik me kërkesë dhe ofertë të rregulluar bazuar në çmimin e tregut të prostitucionit. Ky model rregullohet me ligj (Gjermani) (<http://www.europarl.europa.eu>).

<sup>8</sup> Raport i Komitetit të të Drejtave të Grave dhe Barazisë Gjinore mbi shfrytëzimin seksual dhe ndikimin e tij në barazinë gjinore (<http://www.europarl.europa.eu>).

<sup>9</sup> <http://www.europarl.europa.eu>.



mbarë botën është i lidhur drejtpërdrejt me trafikimin e vajzave dhe të grave, madje burimi kryesor i trafikimit të grave në nevojë dhe të vajzave nga mosha 13–25 vjeç. Sipas të dhënave të Komisionit Evropian, shumica e viktimave (62%) janë trafikuar për shfrytëzim seksual, ku gratë dhe vajzat përbëjnë rreth 96% të viktimave të identifikuar dhe të prezumuara.<sup>10</sup> Duke qenë se prostitucioni është një faktor thelbësor në krimin e organizuar, madje organizohet në një shkallë të gjerë prej tij, duke funksionuar si një treg me kërkesa nxitëse për furnizimin me atë shërbim, krahas zbatimit të ligjit për të gjurmuar e dënuar kriminelët, në të njëjtën kohë nevojitet të mbrohen edhe viktimat, personat e prostituuar, si dhe gratë e vajzat e trafikuar për shfrytëzim seksual, pa harruar shfaqjen e këtij fenomeni në forma të sofistikuar si, për shembull, prostitucioni përmes internetit.<sup>11</sup>

15. Faktet e mësipërme shpjegojnë qartësisht arsyet e miratimit të një sërë instrumenteve ndërkombëtare që e konsiderojnë prostitucionin si problematik. Përmendim Konventën e OKB-së së vitit 1949 “Mbi shtypjen e trafikimit të personave dhe shfrytëzimit të prostitucionit të të tjerëve”, e cila shprehet se “*prostitucioni dhe trafikimi i personave për qëllime prostitucioni janë të papajtueshme me dinjitetin dhe vlerat njerëzore dhe vënë në rrezik mirëqenien individuale, familjen dhe komunitetin*”. Kjo dispozitë e përkufizon prostitucionin si të papajtueshëm me Deklaratën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Njeriut të 1948-s, e cila garanton dinjitetin njerëzor dhe integritetin për të gjithë.

16. Neni 6 i Rekomandimit të Përgjithshëm 19 të OKB-së mbi Dhunën ndaj Grave pranon se varfëria dhe papunësia i detyrojnë shumë gra dhe vajza të reja të përfshihen në prostitucion. Po ashtu, neni 8 i Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Dhunës ndaj Grave (CEDAW) dhe neni 6 i Deklaratës për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (DEVAW) u kërkojnë shteteve të luftojnë dhe shtypin të gjitha format e trafikimit të grave

dhe shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve.<sup>12</sup>

17. Standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në drejtim të garantimit të barazisë gjinore në shoqëri, të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual të tyre janë reflektuar në një sërë ligjesh dhe strategjish të miratuara nga shteti shqiptar, i cili mbetet i angazhuar në sigurimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave si në aspektin ekonomik, ashtu edhe atë politik. Megjithatë ky angazhim duket se është joreal nisur nga argumentet e parashtruara nga palët e interesuara, se shoqëria shqiptare nuk është ende gati për ta legalizuar këtë fenomen. Madje edhe rrëzimi i kërkesës nga ana e shumicës është një hap pas, sepse krijon premisat për të jetuar në një shoqëri ku fenomeni i prostitucionit të detyruar, i shfrytëzimit seksual të prostitucionit, do të vazhdojnë të gjenerojnë pasoja psikologjike dhe psikike shkatërruese dhe afatgjata për personat e përfshirë (edhe pas largimit nga kjo veprimtari), veçanërisht për fëmijët dhe adoleshentët. Po ashtu, vendimi i shumicës garanton edhe gjenerimin e stereotipave gjinore dhe të të menduarit mbi baza stereotipes mbi shitjen e trupit nga gratë për të kënaqur kërkesën mashkullore për shërbime seksuale.

18. Në vështrim të sa më sipër vlerësoj se shfuqizimi i paragrafit të parë të nenit 113 të Kodit Penal nuk e dekriminalizon prostitucionin, sepse paragrafi i dytë dënon dhënien e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit me gjobë ose burgim deri në tre vjet. E formuluar në këtë mënyrë dispozita në fjalë dënon blerësin dhe lehtësisht përafrohet me parashikimet e legjislacioneve që sot cilësohen si përjasje moderne ndaj prostitucionit. Neni 113, pa paragrafin e parë, jo vetëm nuk krijon premisat për një shoqëri kundër moralit, por përkundrazi është një mundësi reflektimi nga ana e ligjvënësit dhe shoqërisë ndaj vlerave që janë të mishëruara në ligjin themelor të vendit, si dinjiteti dhe barazia, që ato të mos mbeten teorike dhe iluzore, por praktike dhe reale. Asnjëherë nuk është vonë për të krijuar e forcuar një shoqëri ku gratë e vajzat të ndihen të mbrojtura në aspektin social, ekonomik, fizik,

<sup>10</sup> European Parliament resolution of 26 February 2014 on sexual exploitation and prostitution and its impact on gender equality.

<sup>11</sup> European Parliament, Study on “National Legislation on Prostitution and the trafficking in women and children”, Policy Department C, 2005.

<sup>12</sup><http://www.endviolenceagainstwomen.org.uk/data/files/resources/62/EVAW-Submission-on-Amnesty-consultation-FINAL.pdf>



psikologjik, emocional dhe po ashtu të respektuara për atë çfarë në të vërtetë ato përfaqësojnë. Politika e moralit, e cila bazohet tek ideologjia dhe është rezistente ndaj fakteve, mund të jetë justifikimi në këtë rast, por jo pengesa për të bërë ndryshim. Gjykata Kushtetuese, përmes vendimit të saj, mund të kishte dhënë shembullin më të mirë të garantimit të respektimit të Kushtetutës dhe eliminimit nga sistemi ligjor shqiptar të atyre normave që bien ndesh me parimet, standardet dhe vlerat kushtetuese.

Anëtare: Vitore Tusha

**VENDIM**  
**Nr. 72, datë 27.11.2015**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.9.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 43 Akti, që u përket palëve:

KËRKUES: Sami Rasha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Punëve të Brendshme;

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;  
Shoqëria Përmbarrimore Gjyqësore Private “ARB” sh.p.k., Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 7573, datë 26.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 28 e vijues i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar Drejtoria e Policisë së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar shoqëria përmbarrimore gjyqësore “ARB” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuari Sami Rasha, me gradën kryekomisar, ka kryer detyrën e drejtorit të Qendrës së Studimeve të Kualifikimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

2. Me urdhrin nr. 1509, datë 13.9.2006, të zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, ai është caktuar në një pozicion më të ulët në detyrë, konkretisht përgjegjës i Seksionit të Formimit të Rolit Bazë. Me urdhrin nr. 1509/1, datë 19.9.2006, të zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, i është caktuar grada “nënkomisar”, për shkak të mospërputhjes së gradës policore me funksionin organik, duke iu ulur edhe paga mujore.

3. Duke mos qenë dakord me urdhrat e mësipërme, kërkuari është ankuar pranë organit më të lartë hierarkik të Ministrisë së Brendshme, ankimi i cili është rrëzuar. Për rrjedhojë, ai i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt shfuqizimin e urdhrave nr. 1509, datë 13.9.2006 dhe nr. 1509/1, datë 19.9.2006, të zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, dhe rivendosjen e së drejtës në funksionin dhe gradën përkatëse.

4. Me vendimin nr. 7573, datë 26.12.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Shpalljen si të pavlefshëm të aktit administrativ të përfaqësuar nga urdhri nr. 1509, datë 13.9.2006. Shpalljen si të pavlefshëm të aktit administrativ të përfaqësuar nga urdhri nr. 1509/1, datë 19.9.2006. Detyrimin e të paditurit të rivendosë të drejtat e cenuara në funksionin e mëparshëm, si rezultat i pavlefshmërisë së akteve. Detyrimin e të paditurit të paguajë pagën prej 85.470 lekësh në muaj, që i përket gradës kryekomisar, duke filluar që nga data 16.9.2006 e në vazhdim.”.



5. Me vendimin nr. 829, datë 18.4.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 7573, datë 26.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.*”. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Me vendimin nr. 00-2012-1450 (199), datë 19.4.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 829, datë 18.4.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Lënien në fuqi të vendimit nr. 7573, datë 26.12.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me këtë ndryshim: detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit pagën prej 85.470 lekësh në muaj që i përket gradës kryekomisar për një vit.*”.

7. Me vendimin nr. 4227 akti, datë 29.7.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr. 7573, datë 26.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Kërkuesi i është drejtuar shërbimit përbarimor gjyqësor privat për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Për arsye se nga ana e debitorit nuk është ekzekutuar ende ajo pjesë e vendimit që ka disponuar kthimin e kërkuetit në punë, ai i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

## II

9. **Kërkuesi Sami Rasha** pretendon cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, për pjesën që i takon kthimit në punë, brenda një afati të arsyeshëm, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

9.1 Edhe pse në vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së është sanksionuar se kur debitore janë organet shtetërore detyrimet duhet të ekzekutohen drejtpërdrejt, kërkuetit i është kërkuar nga ana e debitorit që t’i drejtohet zyrës përbarimore për ekzekutimin e detyrimit.

9.2 Nga data e largimit të kërkuetit nga detyra kanë kaluar 8 vjet e 7 muaj, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në të tria shkallët e gjykimit. Me gjithë këto vonesa për gjykimin e çështjes (6 vjet) vendimi përsëri ka

mbetur i paekzekutuar dhe pala debitore nuk ka treguar interesin më të vogël për përmbushjen e detyrimit. Mospërmbushja e detyrimit, aq më tepër kundërshtimi i hapur për të zbatuar urdhrin e përbaruesit për ekzekutim të detyrueshëm, cenon rëndë parimin e sigurisë juridike dhe të besimit si në organet e ngarkuara me ekzekutimin e detyrueshëm, ashtu edhe në organet që janë të detyruara të përmbushin detyrimet e tyre.

9.3 Edhe pse ishte në dijeni të plotë për vendimin e marrë nga Gjykata e Lartë, debitori nuk ka treguar asnjë interesim për të ndrequr gabimin në zbatimin e vendimit. Duke qenë se aktet e nxjerra nga zëvendësministri i Brendshëm gjykata i ka konsideruar të pavlefshme, pala debitore ishte e detyruar të merrte masat e nevojshme për kthimin e kërkuetit në detyrën e mëparshme.

10. **Subjekti i interesuar, Drejtoria e Policisë së Shtetit**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës është shprehur:

10.1 Pretendimi për njohjen e detyrimit monetar nga data 16.9.2006 deri në zbatimin tërësisht të urdhrin të ekzekutimit është i pabazuar, pasi me vendimin e Gjykatës së Lartë është përcaktuar si detyrim përfundimtar ai për pagesën e pagës që i përket gradës kryekomisar për një vit. Ky detyrim është likuiduar tërësisht me urdhërshpenzimin nr. 568, datë 25.11.2014, në shumën 1.025.640 lekë, si edhe në shumën 59.077 lekë është likuiduar tarifa përbarimore.

10.2 Për sa i përket mundësisë së kthimit në punë kërkuetit i është kthyer përgjigje duke e sqaruar se për momentin mungojnë funksionet e lira për t’u sistemuar sipas vendimit gjyqësor.

11. **Subjekti i interesuar, shoqëria përbarimore gjyqësore private “ARB” sh.p.k.**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës është shprehur se i ka kryer veprimet përbarimore në përputhje të plotë me ligjin. Kjo rezultoi edhe nga shkresa nr. 2789/3 prot., datë 9.6.2015, e Ministrisë së Drejtësisë për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve përbarimore, me të cilën i është përgjigjur Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, se procedurat përbarimore në rastin konkret janë kryer sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile.



### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

12. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuarit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131/f dhe 134, pika 1/g dhe pika 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton që kërkuari duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 52, datë 20.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Gjykata vlerëson se kërkuari ka interes të ligjshëm për të kërkuar zbatimin e vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe se në rastin konkret ai u është drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e së drejtës së tij. Për ekzekutimin e vendimit gjyqësor kërkuari i është drejtuar debitorit për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si edhe shërbimit përmbarimor për fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm.

14. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuari legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, pasi ai ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion dhe se nuk ka mjet tjetër për rivendosjen e së drejtës të cenuar.

B. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

15. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar

në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa vlerë. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjykimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësish. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesit i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave



normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse.

*i) Komplexiteti i çështjes*

20. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Komplexiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojnë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 15, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm për kthimin e kërkuarit në punë dhe pagimin e pagës që i përket gradës kryekomisar për një vit. Kjo çështje në vlerësimin e Gjykatës nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojnë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuarit është me rëndësi në këtë kontekst.

*ii) Interesi dhe sjellja e kërkuarit*

22. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Gjykata ka theksuar se përdorimi nga ana e kërkuarit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin konkret interesi i kërkuarit është i dukshëm dhe real, për sa kohë që detyrimi i palës debitore lidhet me të drejtën e tij për kthimin në punë dhe pagesën e pagës për një vit.

Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezultojnë se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për ekzekutimin e detyrimit që buron nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Ai ka shfaqur interes të vazhdueshëm për ekzekutimin dhe nuk rezultojnë të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

24. Pas marrjes formë të prerë të vendimit, me kërkesën e datës 9.9.2014, kërkuari i është drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme për ekzekutimin vullnetar të detyrimit.

25. Me shkresën nr. 4172/1 prot., datë 17.10.2014, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i është përgjigjur kërkuarit se që vendimi të ekzekutohet, ai duhet t'i drejtohet zyrës së përbarimit nën juridiksionin e të cilës ndodhet pasuria e debitorit.

26. Për pasojë, në datën 21.10.2014 kërkuari i është drejtuar përbaruesit gjyqësor për fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

*iii) Sjellja e autoriteteve*

27. Gjykata ka theksuar se në fazën e ekzekutimit marrin pjesë jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori nuk pranon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin nr. 24, datë 22.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Kur autoritetet administrative refuzojnë, neglizhojnë ose vonojnë t'i ekzekutojnë këto vendime, garancitë që gëzon një palë e përfshirë në një proces gjyqësor e humbasin qëllimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimin nr. 8, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në lidhje me autoritetet publike të përfshira në këtë proces duhet të shqyrtohet





sjellja e secilit prej tyre. Për sa u përket veprimeve të përmbartuesit gjyqësor privat, si subjekt procedural në fazën e ekzekutimit, rezulton se shoqëria “ARB” sh.p.k., i është drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme me shkresën nr. 1/262 prot., datë 22.10.2014, “Lajmërim për ekzekutim vullnetar”. Me shkresën nr. 2/262 prot., datë 29.10.2014 është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros konservative në llogaritë e thesarit dhe bankare të debitorit. Me shkresën nr. 4/262 prot., datë 1.12.2014 është urdhëruar vendosja e masës së sekuestros ekzekutive në llogarinë e debitorit në shumën 1.084.717 lekë dhe kalimi i saj në llogarinë e shoqërisë përmbartimore. Me shkresën nr. 5/262 prot., datë 4.12.2014 është vendosur heqja e sekuestros konservative nga llogaritë e debitorit me kërkesë të kreditorit, pasi është shlyer detyrimi në të holla. Ndërkohë që nga ana e shoqërisë përmbartimore “ARB” sh.p.k., ka vijuar njoftimi drejtuar debitorit për ekzekutimin e plotë të detyrimit me shkresat nr. 6/262 prot., datë 4.12.2014; nr. 8/262 prot., datë 6.1.2015; nr. 9/262 prot., datë 3.2.2015; nr. 11/262 prot., datë 20.2.2015 etj. Për pasojë, Gjykata vlerëson se ky subjekt jo vetëm që nuk është bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, por ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

30. Në lidhje me sjelljen e debitorit, Gjykata vëren se për sa i përket pjesës së vendimit që i referohet pagesës së pagës për një vit, e cila i korrespondon gradës kryekomisar, rezulton që detyrimi të jetë shlyer plotësisht në favor të kërkuarit me urdhër-pagesën nr. 568, datë 25.11.2014, në shumën 1.025.640 lekë, kurse me shumën 59.077 lekë është likuiduar tarifa përmbartimore.

31. Për sa i përket asaj pjese të detyrimit që i referohet rikthimit të kërkuarit në punë, nga ana e subjektit të interesuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është pretenduar, si gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, ashtu edhe në parashtrimet drejtuar Gjykatës, se për momentin mungojnë funksionet e lira për sistemimin e tij në strukturat e policisë së shtetit. Edhe pse debitori e ka njohur detyrimin, ai nuk rezulton të ketë marrë masa për të bërë të mundur ekzekutimin e tij.

32. Gjykata ka theksuar se i takon debitorit të

gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme, me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit. Autoritetet shtetërore nuk mund të justifikohen me pamundësinë objektive për të mos respektuar një detyrim që vjen nga një vendim gjyqësor, por duhet të përpiqen me të gjitha mjetet dhe mundësitë që kanë në dispozicion për ta zbatuar atë. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej inefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Bazuar në standardet e mësipërme dhe referuar veprimeve konkrete dhe sjelljes së debitorit, Gjykata vlerëson se pretendimi për mungesën e vendeve të lira për sistemimin e kërkuarit nuk e shmang debitorin nga detyrimi për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Ai duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme dhe duhej të gjente mjetin e përshtatshëm ligjor për kthimin e kërkuarit në punë, si një detyrim ligjor, i cili rrjedh nga një vendim gjyqësor që tashmë është titull ekzekutiv.

34. Në përfundim, Gjykata konstaton cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, në pjesën që i referohet kthimit të kërkuarit në punë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “P” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,



## VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.  
- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 7573, datë 26.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Vitore Tusha

## KËRKESE

Shtetasi Haziz Peposhi, i biri i Fehtahut dhe i Baftijes, i datëlindjes 8.5.1968, lindur në Lusen, Kukës, dhe banues në Katund i Ri, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të vdekur të vëllait të tij, shtetasit Adem Peposhi, i datëlindjes 21.3.1974.

KËRKUES  
**Haziz Peposhi**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë